

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes

-SPECIALIST NË DREJTORINË E POLITIKAVE TË INTEGRIMIT TREGTAR

Në zbatim të ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", Departamenti i Administratës Publike rishpall konkurimin për 1 vend të lirë, në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Politikave të Integrimit Tregtar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë (për nivelin e diplomave referojuni Udhëzimit nr. 4 dt. 17.02.2010)
- Të zotërojë gjuhën angleze
- Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese

Paga për pozicionin: është në kategorinë III-b

Paraqitja e dokumenteve:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 17.01.2013 në Kutinë Postare Nr.1751 të Departamentit të Administratës Publike, këto dokumenta: kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, çertifikatave të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit (nëse ka), vërtetimin e gjendjes gjyqësore, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

KONKURIMI është i hapur për nëpunësit civil të së njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, nëse vendi nuk plotësohet nga këta kandidatë, konkurimi zhvillohet me kandidatët jashtë Administratës Publike, sipas procedurave të shërbimit civil.

Pas verifikimit paraprak, më datë 22.01.2013 në selinë e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës do të shpallet lista e konkurentëve, që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi MSA dhe Marreveshjet rajonale apo dypaleshe të tregtisë së lire, Ligji 9131 dt. 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligjin nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të në ushtrimin e funksioneve publike", Ligji nr. 8503 dt 30.06.199 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", Ligji nr. 9049 dt. 10.04.2003 "Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nepunesve publike".